



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.343/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuese BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 23.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, e cila identifikohet me shenjë ZL.Anr.343/2017 e datës 22.10.2017, e parashtruar kundër subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se në një konferencë për shtyp të mbajtur gjatë ditës së zgjedhjeve, sekretari i degës së PDK-së në Prishtinë, Bujar Cakolli, denoncoi Vetëvendosjen për shpërndarjen e fletushkave propaganduese në disa lagje të Prishtinës. Më tej parashtruesi i ankesës thekson se Bujar Cakolli ka ftuar KQZ-në që të marrë masa dhe ka paralajmëruar se gjatë ditë do të deponoj ankesë në PZAP. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 36 paragrafi 1, pika b), të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një CD, lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës BIRN dhe Internews Kosova, lidhur me shkeljen e pretenduar të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, Paneli i vlerësoj si të pabazuara dhe si të tilla i refuzoj për arsye se deklarata e përfaqësuesit në fjalë, nuk ka të bëjë me thyerjen e heshtjes zgjedhore, mirëpo ka të bëjë me deklarimin për shqetësimin e subjektit të tij politik lidhur me pretendimin e thyerjes së heshtjes zgjedhore të një subjekti tjetër politik.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZL. Anr.343/2017 më datën 23.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*